



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHENDETESISE
DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI UNIVERSITAR OBSTETRIK - GJINEKOLOGJIK
“MBRETËRESHA GERALDINE”

Nr. _____ Prot.,

Datë 07.05.2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Devis sh.p.k. NIPT: K 31420012 M, me adrese, Rruga Siri Kodra, Magazina Nr.10, kati 1, ne zonen kadastrale 8330, Nr.Pasurie 1/1136, ngjitur me Kozmo Plastika, prane Uzines se Dinamos se Re, Njesia Bashkiake Nr.8, Tirane

* * *

Procedura e prokurimit: **Prokurim Elektronik – Tender i Hapur**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-91166-10-23-2018**

Public Health Sector

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Per sherbimin e lavanderise dhe hotelerise ne pavionet e S.U.O.GJ “Mbreteresha Geraldine” - Marrëveshje Kuadër me nje operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar (24 muaj)**

Viti	Dite kalendarike	Sasia orientuese e materialit qe do te lahët, kg ne dite
viti 1	365	757
viti 2	365	757

Afati i sherbimit: deri brenda 24 muajve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër, sipas kerkeses se AK.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët per njesi + oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. **Sanitary Cleaning sh.p.k. NIPT: L 42429004 B**
çmimi per njesi i ofruar/Vlera 280 (dyqind e tetedhjetë leke)
2. **Devis sh.p.k. NIPT: K 31420012 M**
çmimi per njesi i ofruar /Vlera 294,50 (dyqindnentedhjetë e kater leke e pesedhjetë qindarka)
3. **Univers Servis sh.p.k. NIPT: L01703501S**
çmimi per njesi i ofruar /Vlera 295 (dyqind e nentedhjetë e pese leke)

Jane s'kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

Sanitary Cleaning sh.p.k. NIPT: L 42429004 B
çmimi për njesi i ofruar/Vlera 280 (dyqind e tetedhjetë leke)

Gjate shqyrtimit të dokumentacionit administrativo ligjor u konstatua se O.E Sanitary Cleaning sh.p.k. NIPT: L42429004B, nuk ka paraqitur dokumentacion të plote. Me dokumentacionin e dorezuar nga kjo shoqëri nuk plotësohen të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim të percaktuara sipas DST-se, si më poshtë:

- Referuar pikës 6, të kriterëve, ku kërkohet *qe ofertuesi të paraqesë, deklaratë qe verteton se disponon personelin Teknik ose inxhinier elektronik / elektromekanik / mekanik / (të shoqëruar me diplomën perkatese), e nevojshëm për realizimin e kësaj kontrate, O.E Sanitary Cleaning sh.p.k. nuk ka paraqitur deklaratë qe disponon se ka Teknik ose inxhinier elektronik / elektromekanik / mekanik / si dhe diplomën perkatese, të bashkangjitur.*
- Referuar shtojcës Nr. 1, “Formulari ofertë”, gjatë vlerësimit të ofertës konstatohet se :
Sasia ditore e larjeve, sipas specifikimeve teknike të kerkuara, bashkelidhur DST-se, përlogaritja e saktë nga ana e ofertuesve duhet të jete, si më poshtë :

Viti	Dite kalendarike	Sasia e materialit qe do të lahet kg ne dite	Sasia totale e larjeve kg ne vit	Çmimi pa TVSH leke/kg	Fondi pa tvsh
Viti 1	365	757	276305		
Viti 2	365	757	276305		
Totali			552610		

Sqarim: 552610 kg = 757 kg/dite * 365 dite * 2 vite

Nga përlogaritja e sasise se kerkuar nga ana e A.K. është 757 kg/dite, ndërsa formulari i dorezuar nga O.E. nga përlogaritja matematikore, rezulton si më poshtë:

534610 kg x 280lek/kg = 149, 690, 800 lek pa tvsh

Si konkluzion sasia e larjeve/kg për dite, përlogaritur nga ana e O.E. Sanitary Cleaning është 732.34 kg/dite nga 757 kg/dite qe duhet të jete, sipas kërkesës së A.K.

Formulari i ofertës nga O.E. Sanitary Cleaning duhet të ishte, si më poshtë:

552610 kg (757 kg/dite * 365 dite * 2) x 280 lek/kg = 154,730,800 lek pa tvsh.

- O.E. ka paraqitur dokument për kriterin *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së kontratës që prokurorët, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit; Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme janë realizuar me ent publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim dhe fatura tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, ose, kur shërbimet e mëparshme të ngjashme janë realizuar me*

subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes ku shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”,

O.E. ka paraqitur “Fatura tatimore mbi ushtrimin e aktivitetit viti 2016, 2017, 2018 dhe 2019 me Subjektet: “Deja Turizem” sh.p.k., “Spitali Amerikan” sh.a. ne vleren **36,967,431 leke pa tvsh**

dhe

“Fatura Tatimore te ngjashme dhe realizim kontrate me “Spitalin Rajonal Durres”, me Shkrese Nr. 583/1 date 28.03.2019 “Realizim financiar te Kontrates Nr.1905/4 Prot., date 26.09.2017” dhe me Shkresen Nr. 583 date 20.03.2019 “Informacion, Vetem mbi Realizim financiar te Kontrates Nr.1905/4 Prot., date 26.09.2017” ne vleren 72,303,600 lek pa tvsh,

ne te cilen nuk eshte percaktuar se sa % te kontrates ka realizuar O.E. “Sanitary Cleaning” (Kontrata Nr.1905/4 Prot., date 26.09.2017, me objekt prokurimi “Furnizimi i Shërbimit te lavanderise ne Spitalin Rajonal Durres” , B.O.A. “A.G.Lundry”, “Sanitary Cleaning” Mimoza Deliu PF”.

Ne zbatim te kërkeses se A.K. paraqitur ne D.S.T., *Kapaciteti teknik, pika 7, “Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe disponon makineri per larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karrela shërbimi deri tek shtrati i pacientit, me kapacitet larjeje minimum 757/dite, te vertetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi te shoqeruara me foto) si me poshte vijon:*

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Makineri Larese me kualitet te larte larjeje me disa dhoma larje te cilat duhet te jene te lidhura me system dozimi i cili permbush pastrimin e te gjithë bazes materiale	Cope	1
2	Makineri per dezinfektimin e karrocave dhe koshave metalike me sistem dozimi	Cope	1
3	Makineri Larëse jo me te vogel se 50 kg	Cope	6
4	Makineri larese me dy porta barrier profesionale me kapacitet larese jo me te vogel se 50 kg	Cope	1
5	Makineri Hekurosëse (Rul) Profesionale	Cope	2
6	Makineri tharëse profesionale me kapacitet thares jo me te vogel se 50 kg	Cope	5
7	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Cope	1
8	Kosha metalik (karrela per mbajtje rrobash)	Cope	10
9	Karroca stacioni (karrela shërbimi ne pavion per rrobat)	Cope	10
10	Peshore elektronike mbi 100 kg	Cope	1

Keto makineri duhet te jene te instaluara ne ambientet e Lavanderise te cilat verifikohen nga KVO pas hapjes se ofertave.

K.V.O. ushtroi verifikimin per kërkesen e mesiperme sipas **Proces Verbalit** te mbajtur ne daten **10.04.2019**, (bashkangjitur), si me poshte:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia sipas DST-se	Sasia ne fakt sipas Proces Verbalit ne daten 10.04.2019	
1	Makineri Larese me kualitet te larte larjeje me disa dhoma larje te cilat duhet te jene te lidhura me system dozimi i cili permbush pastrimin e te gjithë bazes materiale	Cope	1	1	Ploteson specifiket teknike sipas DST-se se kerkuar
2	Makineri per dezinfektimin e karrocave dhe koshave metalike me sistem dozimi	Cope	1	1	Ploteson specifiket teknike sipas DST-se se kerkuar
3	Makineri Larëse jo me te vogel se 50 kg	Cope	6	6	Ploteson specifiket teknike sipas DST-se se kerkuar

4	Makineri larese me dy porta barrier profesionale me kapacitet larese jo me te vogel se 50 kg	Cope	1	1	Ploteson specifiket teknike sipas DST-se se kerkuar
5	Makineri Hekurosese (Rul) Profesionale	Cope	2	2	Ploteson specifiket teknike sipas DST-se se kerkuar
6	Makineri tharëse profesionale me kapacitet thares jo me te vogel se 50 kg	Cope	5	5	Ploteson specifiket teknike sipas DST-se se kerkuar
7	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Cope	1	1	Ploteson specifiket teknike sipas DST-se se kerkuar
8	Kosha metalik (karrela per mbatje rrobash)	Cope	10	20	Ploteson specifiket teknike sipas DST-se se kerkuar
9	Karroca stacioni (karrela sherbimi ne pavion per rrobat)	Cope	10	25	Ploteson specifiket teknike sipas DST-se se kerkuar
10	Peshore elektronike mbi 100 kg	Cope	1	1	Ploteson specifiket teknike sipas DST-se se kerkuar

Persa me siper KVO ne unanimitet vendos te mos kualifikoje oferten e shoqerise Sanitary Cleaning sh.p.k. NIPT: L42429004B.

Univers Servis sh.p.k. NIPT: L01703501S

çmimi për njësi i ofruar /Vlera 295 (dyqind e nentëdhjetë e pesë leke)

* * *

Gjate shqyrtimit te dokumentacionit administrativo ligjor u konstatua se O.E Univers Servis sh.p.k. NIPT: L01703501S, nuk ka paraqitur dokumentacion te plote. Me dokumentacionin e dorezuar nga kjo shoqeri nuk plotesohen te gjitha kerkesat e pergjithshme dhe te veçanta per kualifikim te percaktuara sipas DST-se, si me poshte:

- O.E. nuk ka paraqitur dokument per kriterin **“Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”**
- O.E. nuk ka paraqitur dokument per kriterin **“Kerkohet qe ofertuesi te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore per xhiron vjetore per vitet 2016, 2017, 2018 e cila duhet te jete jo me vogel se vlera e fondit limit qe konkurren, per sejcilin vit. ”.**
- O.E. nuk ka paraqitur dokument per kriterin **“Kerkohet qe ofertuesi te paraqese kopje te vertetuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore e rrethit perkates , te nje ose me shume bilancave per nje nga vitet 2015, 2016, 2017 ”.**
- O.E. nuk ka paraqitur dokument per kriterin **“Kerkohet qe ofertuesi te paraqese, Vertetim per pagesen e taksave vendore, viti 2018”**
- O.E. nuk ka paraqitur dokument per kriterin **“Çertifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise ISO 9001:2015 sipas konformitetit me standartet europiane. (e vlefshme)”**
- O.E. nuk ka paraqitur dokument per kriterin **“Çertifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te ambientit ISO 14001:2015 sipas konformitetit me standartet europiane. (e vlefshme)”**

- O.E. nuk ka paraqitur dokument per kriterin **“Çertifikate qe verteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit UNI ENI 14065:2016 sipas konformitetit me standartet europiane. (e vlefshme”**
- O.E. ka paraqitur dokument per kriterin **“Operatori ekonomik duhet te disponoje ambjentin ku ushtron veprimtarine e sherbimit te lavanderise:**
Te vertetuar me dokumentacionin perkates te pronesise apo te marrjes me qira (afati ne rastet e marrjes me qira duhet te jete ne perputhje me afatin e kryerjes se sherbimit te lavanderise – objekt prokurimi).
Lavanderia duhet te jete brenda rrethit te Tiranës, kjo distance kerkohet per shkak te specifikes se sherbimit, urgjencave te paparashikuara ne Spital.
Lavanderia duhet te kete minimumi 280 m2 te siperfaqes se saj.
Te shoqeruar me leje nga QKL, Autorizim mjedisor per lananeri me Kod III.1.A ose Leje Mjedisore e tipit “C” per aktivitetin pastrim kimik me Kod III.1.A, leje mjedisore me Kod III.1.A leshuar nga autoriteti perkates.
Te jete shoqeruar me akt-teknik per sa i takon masave mbrojtese ndaj zjarrit”

Dokumentat e paraqitura nga O.E. jane me adrese Xhafzotaj –Durrës.

- O.E. ka paraqitur dokument per kriterin **“Kerkohet qe ofertuesi te paraqese, Vertetim për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik per periudhen, Janar – Dhjetor 2018, jo me pak se 25 punonjes, e vertetuar kjo me:Vertetim nga dega e tatim taksave per numrin e punonjesve te siguruar te shoqeruar me liste pagesat (formulet E-sig 025 a) te konfirmuara nepermjet formes elektronike”,** Dokumentacioni i paraqitur nga O.E. nuk ploteson kushtet e mesiperme.
O.E. ka paraqitur: 1. Liste pagesa Janar 2018 – 15 punonjes, Liste pagesa Shkurt 2018- 16 punonjes, Liste pagesa Mars 2018- 17 punonjes, Liste pagesa Gusht 2018- 19 punonjes, Liste pagesa Shtator 2018- 18 punonjes, Liste pagesa Nentor 2018- 17 punonjes dhe Liste pagesa Dhjetor 2018- 18 punonjes, pra **O.E. nuk ka paraqitur Liste pagesat e muajve Prill, Maj, Qershor, Korrik dhe Tetor 2018.**
Ka paraqitur Vërtetim nga DRT Durrës “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a” me Nr.215/2Prot., Datë, 20.02.2019 per periudhen Janar – Dhjetor 2018 dhe Janar 2019 me **Numer mesatar te fuqise punetore 17.5 punonjes, pra me pak se numri I punonjesve te kerkuar sipas DST-se – 25 punonjes.**
- O.E. nuk ka paraqitur dokument per kriterin **“Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe disponon makineri per larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karrela shërbimi deri tek shtrati i pacientit, me kapacitet larjeje minimum 757/dite, te vertetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi te shoqeruara me foto)”**

O.E Univers Servis sh.p.k. NIPT: L01703501S konkurren per vleren **295** (dyqind e nentdhjete e pese leke pa tvsh)

Gjate kontrollit per gabime aritmetike te ofertes se paraqitur nga O.E nuk u konstatuan gabime aritmetike.

Persa me siper KVO ne unanimitet vendos te mos kualifikoje oferten e shoqerise Univers

Servis sh.p.k. NIPT: L01703501S.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

Devis sh.p.k. NIPT: K 31420012 M

çmimi për njësi i ofruar /Vlera 294,50 (dyqindnentedhjetë e kater leke e pesedhjetë qindarka)

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë /S.U.O.GJ “Mbretresha Geraldine“, zyra e **protokollit**/, brenda 2 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në date **11.04.2019**

Ankesa: ka, dorezuar pranë AK me nr.458 Prot. dt.17.04.2019

(nëse ka) ka marrë përgjigje: me nr.458/1 Prot. dt.24.04.2019 (*elektronikisht dhe me poste*)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

